




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e XII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11 nëntor 2022 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Nurie Halili, Lorik Maxhuni, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Shpëtim Zhegrova, (Nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive, Ismet Gashi - nga zyra ligjore, Ragbete Krasniqi - nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekzistonte shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo tha se sot na është drejtuar me një kërkesë Klubit i hendbollit "Vushtrria" – femrat, për përkrahje financiare. Lidhur me këtë kërkesë, shumica e anëtarëve të komitetit veç ishin të njoftuar.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.10.2022;
2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve;
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për Raportin e Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë;
5. Shqyrtimi i Informatës për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale;
7. Shqyrtimi i kërkesës i Klubit të hendbollit "Vushtrria" – femrat, për përkrahje financiare;
8. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.10.2022.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 13.10.2022.

2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës – deklaroi se Harta Zonale është në proces të hartimit, ku i ka kaluar disa filtra, por fatkeqësisht për shkak të pandemisë, konsultimet publike me qytetarë janë mbajtur në formë elektronike. E dimë që Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) është miratuar në vitin 2017, ku në të njëjtën situatë ka qenë edhe Komuna e Prishtinës, e cila i ka jep një rivlerësim të Planit Zhvillimor Komunal, para miratimit të Hartës Zonale. Kështu që është mirë të diskutohen në kuvend se nëse ka nevojë të bëhet një rivlerësim i Planit Zhvillimor Komunal, që t'i paraprijë miratimit të Hartës zonale, që mos të ketë ndryshime tjera, sepse ajo duhet të bazohet në PZHK. Ai tha kërkesat janë të ndryshme dhe po besoj që ka shumë nevojë të ndryshohet PZHK-ja, sepse një pjesë e madhe e kërkesave kanë qenë edhe premtime elektorale të kryetarit Idrizi, që zona në Bukosh të bëhet zonë industriale në të dy anët e rrugës, po ashtu zona në Shalë duhet të shpallet zonë me interes të veçantë për argoturizëm. Kështu që, konsideroj se duhet të pësojë disa ndryshime PZHK-ja në bazë të ligjit që na lejohet, pasi e ka kaluar një periudhë. Prandaj, nëse e shohim të arsyeshme që t'i japim një kahje tjetër PZHK-së dhe Hartës Zonale, është mirë të diskutojmë në kuvend dhe t'i japim kahje si kuvend i komunës.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se desha t'i ngriti si çështje propozimet që po jepen për KPF dhe për kuvend. Ai tha se propozuesi duhet çdoherë të jetë vetëm kryetari i komunës, e jo drejtoria, e cila asnjëherë nuk mund të propozojë pika të rendit të ditës. Prandaj, për seancën e kuvendit propozoi që të përmirësohet ky gabim. Sa i përket kësaj pike, jemi në një udhëkryq, sepse PZHK-ja është e aprovuar edhe nga ministria, por, duhet ta shikojmë interesin e përgjithshëm, se cili do të jetë impakti nëse shkojmë prapë në rivlerësim të PZHK-së, sepse çdo veprim që ndërmerret, duhet të përmbushen kriteret (dëgjimet publike, takimet me qytetarë, duhet të aprovohen në kuvend ndryshimet, pastaj ministria ta aprovojë) dhe merr një kohë të gjatë ky proces. Nëse shkojmë në këtë formë, atëherë Hartat zonale shtyhen në infinit. Se a është e rëndësishme dhe e ngutshme që të kryhet Harta zonale, kjo është pyetje në vete që duhet të diskutohet edhe me drejtorinë respektive, sepse ata janë më të informuar në këtë sferë. Si komitet, mirë është që ta marrim rolin që na takon ligjërisht dhe t'iu japim kahje propozimeve që me i caktu projektet, të cilat i duhen qytetit. Në rastin konkret, unë kam hezitimet e mia nëse shkojmë në ndryshim – plotësim të PZHK-së, që ndoshta do të shkojë krejt mandati dhe Harta zonale nuk do të mund të fillojë. Por, nëse shkohet me këtë, atëherë duhet të organizohet një takim me ekspertë dhe qytetarë, sepse është përgjegjësi me vendos në këtë drejtim që nuk e dimë a po shkohet në rregullim apo degradim të qytetit. Në parim jam që të shkohet me Harta zonale, sepse është punuar në këtë drejtim.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës – tha se Ilmiu ka të drejtë, sepse materiali duhet të vijë nga kryetari i komunës përmes drejtorive. Lidhur me PZHK, unë vetëm e dhashë si propozim, sepse i skadon afati në vitin 2024. Pra, ne kemi me shku në bazë të këtij plani për ta bërë Hartën zonale. Por, a ka kërkesa që të bëhet kjo, unë e di që ka kërkesa në Drejtorinë për Urbanizëm që nuk po mund të procedohen për shkak se nuk janë në PZHK dhe kjo është ideja.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se në fillim të këtij viti e kemi diskutuar çështjen e Hartave zonale dhe e kemi caktuar një afat që deri në dhjetor të miratohet. Në aspektin profesional nuk i takoj kësaj fushe, megjithatë për nga pesha e PZHK-së që është miratuar për 8

vjet ka qenë njëri nga dokumentet më strategjike, dhe të na sjell një informatë me tre paragrafë, konsideroj që është e pamjaftueshme. Prandaj, drejtoria është dashur të na sjell një informatë më të detajuar dhe të argumentuar, në mënyrë që ne ta kemi pasqyrë, sepse jo të gjithë e kemi votuar, pasi që disa nuk kemi qenë anëtarë kuvendi në atë kohë. Ai kërkoi nga drejtoria përkatëse një informatë më të detajuar në lidhje me zbatimin e këtij plani, duke përfshirë sfidat dhe vështirësitë që po i has ky plan.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tetë (8) vota “për”, një (1) “kundër”, rekomandoi që të plotësohet kjo informatë dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – deklaroi se sa jam në dijeni, drejtoria lidhur me këtë informatë çdoherë bazohet në raportimet që bëhen në ATK. Ai pyeti se a ka arritur drejtoria të identifikojë se sa biznese janë shuar realisht, jo duke u bazuar në ATK?. Kjo për shkak se procedurat për ta mbyll një veprimtari ekonomike janë shumë të vështira dhe të koklavitura

Po ashtu, drejtoria duhet ta ketë një plan dhe të evidentojë se cilat biznese janë rrezikuar nga kriza apo a ka ndonjë shënim se si është gjendja ekonomike në komunën tonë. Sepse, pikërisht kjo drejtori është dashur t'i ketë këto shënime dhe në bazë të tyre me dal me propozime te qeveria komunale, por edhe te niveli qendror që të kërkojë përkrahje financiare për këto kompani që t'iu mundësojnë t'i ruajnë vendet e punës. Prandaj, qasja e drejtorisë duhet të ndërrohet dhe të jetë në shërbim të bizneseve, fermerëve dhe të gjithë atyre që kanë të angazhuar fuqi punëtore, sepse pikërisht ky është interesi i komunës.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – me disa gjëra që i tha parafolësi pajtohem edhe unë. Prandaj, për seancën e kuvendit, drejtoria të na sjell një informacione shtesë, planin që parasheh kjo drejtori apo qeverisja komunale lidhur me përkrahjen apo subvencionimin e bizneseve për shkak të krizës ekonomike dhe inflacionit të madh, si dhe për shkak të rreziqeve që shumë biznese të shuhen.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës – tha se kjo është një informatë sa i përket strukturës së bizneseve, ndërkaq, javën e ardhshme shpallet thirrja për subvencionim të bizneseve.

Ragbete Krasniqi, zyrtare nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – deklaroi se ne jemi një qendër për regjistrim të bizneseve që funksionojmë në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) dhe se ndryshimet dhe regjistrimet bëhen në mënyrë elektronike. Ne e detyrojmë pronarin e biznesit që të marrë një vërtetim nga ATK-ja në mënyrë që ta shohim gjendjen financiare. Lidhur me shuarjen e bizneseve, ajo tha se ky numër është i saktë, kurse sa i përket planit zhvillimor që u kërkua, ajo tha se duhet të jetë edhe zyra e zhvillimit, por në mungesë të punëtorëve nuk mund të arrihet kjo. Të gjitha pyetjet e parashtruara që nuk kanë marrë përgjigje, le të adresohen me shkrim dhe si drejtori do t'ju përgjigjem.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tetë (8) vota “për”, një (1) “kundër”, rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për Raportin e Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrisë.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – theksoi se Komuna e Vushtrisë ka treguar gatishmërinë dhe përkushtimin e saj për ta hartuar këtë raport, ku qëllimi i tij është ndërtimi i një standardi të ri të bashkëpunimit mes komunës, shoqërisë civile dhe sektorit privat, me qëllim të përafrimit sa më të madh të objektivave të <Agjendës 2030>. Kësaj agjende i ka paraprirë miratimi i rezolutës nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2018.

Komuna jonë është mbështetur nga ekipi i OKB-së në Kosovë, dhe jemi ndër komunat e para që iu kemi bashkuar komunave të Kosovës, por edhe rajonit dhe më gjerë për hartimin e këtij raporti.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Informatës për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrisë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tetë (8) vota “për”, një (1) “kundër”, rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – theksoi se ky propozim më ka befasuar, për shkak se kur është themeluar komisioni në kuvend, kemi votuar që të futet një pikë në vendim që parasheh kompensimin. Prandaj, kjo veç është dashur të zbatohet dhe nuk ka pasur nevojë fare të vjen situata deri aty, ku është pezulluar aktiviteti nga ana e komisionit në mungesë të kompensimit. Ai pyeti se lartësia e kompensimit si është përcaktuar? A është bërë sipas dëshirës, apo është bërë sipas normativave ligjore. Ndarja e subvencioneve nuk ka nevojë fare të vjen në kuvend, sepse kryetari i komunës i ka kompetencat e plota të marrë vendim për ndarjen e tyre, sipas Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – lidhur me vendimin që është marrë në kuvend dhe për kompensim të anëtarëve, ajo tha se e ka dëgjuar edhe njëherë incizimin nga mbledhja e kuvendit dhe është votuar që të merret vendim i veçantë për kompensim.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës – deklaroi se sa u përket shërbyesve civilë, kjo është e rregulluar me ligj, por për anëtarët e kuvendit duhet të bëhet me një vendim të veçantë të kuvendit. Prandaj, kjo është arsyeja që e kemi sjell këtë propozim – vendim për kompensim, kurse, sa i përket mënyrës së kompensimit, është themeluar një komision nga kuvendi për hartimin e rregullores për këtë çështje, në të cilën do të parashihet edhe mënyra e kompensimit. Por, duke pasur parasysh bazën financiare, e kemi propozuar këtë shumë. Nëse e shihni të arsyeshme që të ndryshohet shuma financiare, e ndryshojmë nuk është problem, por këtij propozimi do t’i shtohet edhe një pikë, ku do të parashihet kompensimi edhe i komisioneve tjera të kuvendit.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se e përkrah këtë propozim për pagesën e komisionit, por ashtu siç e tha nënkryetari, edhe unë propozoj që të bëhet një propozim – vendim për pagesën e të gjitha komisioneve të themeluara nga kuvendi. Ai propozoi që vlera financiare për një mbledhje të jetë 30 euro, e jo 20 euro siç është propozuar. Tutje tha se kompensimi i anëtarëve të komisioneve të bëhet nga data 1 janar 2022 deri në hartimin e rregullores.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – lidhur me kompensimin e komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale kur është votuar është cekur që në kuadër të atij vendimi, të nxjerret një vendim

i veçantë për kompensim, prandaj është dashur të procedohet me pagesa, duke shtuar se pajtohet me propozimin që të paguhet të gjitha komisionet që janë themeluar në vitin 2022.

Hava Mlinaku, drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë – lidhur me këtë propozim – vendim, ka qenë diskutabile kategoria nga e cila do të bëhen pagesat. Prandaj, deri në kuvend jemi duke e shqyrtuar këtë propozim, se nga cila kategori do të bëhen pagesat.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – deklaroi se për kuvend duhet të sjellet një propozim – vendim i ri për pagesën e komisioneve të themeluara nga kuvendi.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës si vijon:

“Të bëhet kompensimi i anëtarëve të komisioneve të formuara nga kuvendi, që nga data 1.1.2022 deri në hartimin e Rregullores për komitetet dhe komisionet e kuvendit. Lartësia e kompensimit për çdo takim caktohet në shumën prej 30€ për anëtar të komisionit, në bazë të proceverbalit për mbajtjen e takimit”.

7. Shqyrtimi i kërkesës i Klubit të hendbollit “Vushtrria” – femrat, për përkrahje financiare.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – theksoi se shumica prej neve i dimë problemet e këtij klubi, por edhe klubeve tjera. Deklaroi se shuma prej 5000 € për këtë klub është dashur të kryhet, që i takon me rregullore në bazë të çmimit të fituar. Po mbetet kërkesa për 10000 €, prandaj, duhet të gjenden mundësitë financiare për ta përkrahur kërkesën e këtij klubi, në mënyrë që t’i zhvillojë aktivitetet pa pengesa. Ai propozoi që t’i ndahet shuma prej 10000 € ndaras nga shuma financiare prej 5000 €.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës – deklaroi se secili prej neve e ka vullnetin që ta përkrah jo vetëm këtë klub, por edhe klubet tjera që janë në gjendje të vështirë financiare. Por, e dimë që ligjërisht ndarja e subvencioneve bëhet me thirrje publike që i bën Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërkaq, shuma prej 5000 € besoj që shpejt do të ekzekutohet, sepse i takon në bazë të rregullores.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se pasi që e kemi kërkesën, mund të marrim vendim si kuvend që pa thirrje publike që të realizohet kjo kërkesë, sepse janë në gjendje të rëndë financiare, kurse pjesa tjetër mund të bëhet përmes thirrjes publike.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – theksoi se secili anëtar i kuvendit e ka vullnetin që ta përkrah këtë klub, por edhe klubet tjera, por duhet t’i shqyrtojmë të gjitha mënyrat ligjore për t’iu dalë në ndihmë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se shuma prej 5000 € i takon sipas rregullores, sepse kanë fituar me garë dhe kjo shumë duhet t’iu kryhet shpejt, kurse, shuma prej 10000 € duhet t’iu ndahet me thirrje publike, ashtu qysh e parasheh rregullorja.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – propozoi që çmimi prej 5000 € të bëhet me ceremoni, në shenjë nderimi për rezultatin e arritur si klub.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – po më pëlqen ideja që të bëhet me ceremoni, por, jo vetëm ceremonia, por nëse klubi ka mundësi dhe drejtoria t’i ndihmojë që të përgatitet një ekspozitë dhe të pasqyrohen rezultatet e të klubit me fotografi ndër vite.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

8. Të ndryshme.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – kërkoi informacione lidhur me Parkun industrial se deri ku ka shkuar procesi?

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – ende nuk kemi marrë përgjigje nga institucionet e drejtësisë për këtë çështje. Në momentin që ka ndonjë risi, do t'ju njoftojmë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – kryesuese të kam shkruar zyrtarisht edhe në e-mail, por nuk kam marrë përgjigje. Ai tha se në seancën e kuvendit jemi pajtuar që të vjen në këtë seancë ideja e themelimit të komiteteve tjera që parashihen me LVL. Kërkoj nga ju që t'i thërrisni shefat e grupeve kuvendare dhe të dakordohemi për fushat në të cilat do t'i themelojmë komitetet, numrin e tyre dhe formulën e përfaqësimit.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – deklaroi se udhëzimi administrativ e parasheh themelimin e këtyre komiteteve që nuk thotë se janë obligative themelimi i tyre, sepse thotë <mund të jenë>. Ne në kuvend e kemi themeluar një komision, i cili e ka për obligim që të hartojë Rregulloren për komisione dhe komitete, prandaj kërkoi nga komisioni që të mblidhen dhe të fillojnë punën.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës – tha se është mirë që me ligj dhe udhëzim administrativ nuk ndalohen, kështu që ne mund t'i themelojmë. Por, në bazë të kësaj rregulloreje duhet të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e atyre komisioneve, qëllimi i tyre, emërtimet e tyre, numrin e anëtarëve, mënyrën e funksionimit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi



Kryesuese e KK-së dhe e KPF- së

